



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 674/19
701/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina -Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik: OE “Eing Com” SH.P.K - Podujevë, me nr. 674/19, dhe ankesës së OE “Rexha – SH.P.K & Lirigzoni - S - SH.P.K & Lirigzoni SH.P.K” - Prishtinë, me nr. 701/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: “Alfa – I & Konstruktori ing1969” - Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Bulevardit dhe Sheshit-Sheshi i Dëshmorëve në Qendrën e Qytetit” me nr.prok: 615-19-1782-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Podujevë, më datën 01.11.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: OE “Eing Com” SH.P.K - Podujevë, me nr. 674/19, si dhe ankesa e grupit të OE “Rexha – SH.P.K & Lirigzoni - S - SH.P.K & Lirigzoni SH.P.K” - Prishtinë, me nr. 701/19, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Bulevardit dhe Sheshit - Sheshi i Dëshmorëve në Qendrën e Qytetit” me nr.prok: 615-19-1782-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Podujevë.

II. VERTETOHET, Vendimi i AK-së Njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Bulevardit dhe Sheshit - Sheshi i Dëshmorëve në Qendrën e Qytetit” me nr.prok: 615-19-1782-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Podujevë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: OE “Eing Com” SH.P.K - Podujevë, aprovohet si e bazuar, si dhe ankesa e OE “Rexha – SH.P.K & Lirigzoni - S - SH.P.K&Lirigzoni SH.P.K”- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar ankuesve ju bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 17.05.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 17.05.2019.

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 11.09.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde është bërë me dt: 26.10.2019.

Data e Vendimit të AK-së për dhënie të kontratës është bërë me dt: 26.10.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim Eing Com sh.p.k është bërë me dt: 30.09.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim Rexha Com sh.p.k është bërë me dt: 01.10.2019.

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim Eing Com sh.p.k është bërë me dt: 03.10.2019.

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim Rexha sh.p.k është bërë me dt: 03.10.2019.

Operatori ekonomik ankues: OE “Eing Com” SH.P.K - Podujevë, me nr. 674/19, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë: 09.10.2019, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Bulevardit dhe Sheshit - Sheshi i Dëshmorëve në Qendrën e Qytetit” me nr.prok: 615-19-1782-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Podujevë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 65, 69 të LPP-së dhe nenin 41, 28 të RrUOPP-së.

Operatori ekonomik ankues:“Rexha – SH.P.K & Lirigzoni - S - SH.P.K & Lirigzoni SH.P.K” - Prishtinë, me nr. 701/19, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë: 14.10.2019, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“Ndërtimi i Bulevardit dhe Sheshit - Sheshi i Dëshmorëve në Qendrën e Qytetit” me nr.prok: 615-19-1782-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Podujevë,duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 10, 59, 69, 72të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit,konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së,me datë: 15.10.2019, ka autorizuar ekspertin profesionale të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit,në raportin e datës: 25.10.2019,ka sqaruar pretendimet e OE ankues:“Eing Com” SH.P.K – Podujevë, dhe OE: “Rexha – SH.P.K & Lirigzoni - S - SH.P.K & Lirigzoni SH.P.K” - Prishtinë.

Pretendimi i parë i OE ankues është se ne dosje të tenderit në “Aneks 4 Siguria E Tenderit” është bashkangjitur edhe forma e sigurisë se tenderit e cila duhet të dorëzohet, me rastin e ofertimit. Ne këtë formë saktësisht janë paraparë detyrat dhe obligimet e palëve si dhe kushtet, se kur tërhiqet garancioni. OE i rekomanduar për kontratë me rastin e ofertimit ka dorëzuar një garancion (sigurim) nga NLB Banka por që nuk i mbulon të gjitha pikat siç kërkohet në dosje të tenderit përkatësisht ne Aneks 4.Ne garancionin e OE të dorëzuar me ofertë thuhet se garancioni ekzekutohet vetëm ne këto dy raste:

- Aplikuesi ka tërhequr ofertën e tij gjatë periudhës se tenderit,apo
- Pasi qe është shpallur ofertues i suksesshëm, Aplikuesi nuk e ka nënshkruar kontratën lidhur me ofertën e tij dhe / apo nuk e ka siguruar garancionin (et) e kërkuar në ftesën për tender.

Ne kemi kërkuar interpretim ligjor nga KRPP ku pas përgjigjeje nga ana e KRPP-së (dokument shtesë)ja bashkëngjisim kësaj ankese. Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne dokumentacionin në lëndë konstaton se ne DT tek “Aneks 4 Siguria E Tenderit” janë përcaktuara kushtet sipas formës standarde të cilat kërkohen të mbuloj polica e sigurimit. Në ofertën e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është bashkangjitur një dokument “TENDER GARANCION Nr.G0919/2” ku në këtë garancion nuk janë përfshirë te gjitha pikat të cilat kërkohen të mbuloj polica e sigurimit, ne DT janë kërkuar kushtet si në vijim:

- a) Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;
- b) Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;
- c) Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:

- Që të depozitohet sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;
- Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit. Ndërsa në garancionin e OE të dorëzuar me ofertë janë përfshirë vetëm këto dy kushte:
 - Aplikuesi ka tërhequr ofertën e tij gjatë periudhës së tenderit, apo
 - Pasi që është shpallur ofertues i suksesshëm, Aplikuesi nuk e ka nënshkruar kontratën lidhur me ofertën e tij dhe / apo nuk e ka siguruar garancionin (et) e kërkuar në ftesën për tender.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në interpretimin e KRPP (te cilin e gjeni të plotë tek Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet në këtë dokument) ku Grupi i OE Eing Com Sh. P. K.; Sh – Drini Company SH.P.K ka kërkuar nga KRPP që të marrë një interpretim lidhur me sigurimin e tenderit që nuk i ka plotësuar të gjitha kushtet sipas aneksit 4 të DT me dorëzimin e ofertës. Interpretimi i KRPP citoj: Sa i përket sigurimit të tenderit nën 29.5 i RRUOPP-së përcakton format e dorëzimit të tenderit gjithashtu sigurimi i tenderit përmendet edhe në nenin 39.8 të RRUOPP-së ku thotë: Citoj: Në tabelën e nenit të lartcekur ku paraqitet “problemi” dhe udhëzimi “si të veprohet” sa i përket sigurimit të tenderit përcaktohet si në vijim: Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT . Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Gjithashtu në interpretimin e KRPP-së thuhet citoj: sipas neneve të lartpërmendura, kushtet e Aneksit 4 të DT janë obligative dhe duhet të përfshihen në garancion të sigurimit të tenderit. Prandaj eksperti shqyrtues duke u bazuar në nenin 59 paragrafit. 4 të LPP-së dhe në interpretimin e KRPP-së ku bazohet në këtë nen ku thotë: 59.4 Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. KRPP, konsideron se mospërfillja e dispozitave të lartpërmendura nga AK është në kundërshtim me LPP-në dhe RRUOPP –në. Prandaj nga sqarimet e lartpërmendura del se ky pretendim ankimor është i bazuar. Pretendimi tjetër i OE ankues është AK me datë: 16.09.2019 kërkon zgjatjen e afatit të sigurimit të ofertës për 30 ditë, dhe OE i propozuar për dhënie me rastin e sjelljes së policës së re i ka përfshi pikat të cilat

kërkohen të mbuloj polica e sigurimit në këtë fazë të ofertimit e që i bie të këtë ndryshimi material me ofertën dorëzuar.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentet shtesë të cilat janë dërguar nga AK Podujevë në OSHP ku të njëjtat i janë përcjellë ekspertit shqyrtues, sqaron se dokumenti i ofruar “TENDER GARANCION Nr.G0919/4” i cili është ofruar ka ndryshime nga ai i dorëzuar me ofertë ku pas zgjatjes së afatit të sigurimit të ofertës edhe për 30 ditë në këtë garancion janë përfshirë të gjitha pikat e kërkuara në Aneksin 4. të dosjes së tenderit. Prandaj nga sqarimet me lartë del se ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që ka ndryshime në sigurimin e dorëzuar, ku duke u bazuar në interpretimin e KRPP-së ku thotë se kushtet e Aneksit 4 të DT janë obligative dhe duhet të përfshihen në garancion të sigurimit të tenderit dhe nenin 59.4 i LPP-së i cili sqaron qartë se kur mund të kualifikohet një tender si i përgjegjshëm. Pretendimi tjetër i OE ankues është se AK pas pranimit të vendimit të OSHP-së me nr: 3818/19 të datës: 21.08.2019, gjatë rivlerësimit të lëndës në pamundësi ta shpërblej me kontratë OE i tyre të preferuar i cili ishte i papërgjegjshëm nga vendimi i OSHP-së, na eliminon edhe neve duke kaluar te OE tjetër sipas renditjes me çmim i 3-ti me radhë, edhe ky OE i preferuar për AK-në, ku pas qasjes në dokumentacion nga ana jonë shihet qartë që OE-ik i propozuar për dhënie nuk i plotëson kushtet të shpallet i përgjegjshëm dhe AK me rastin e kërkesës për rishqyrtim nga ana jonë e kthen lëndën në rivlerësim dhe përsëri bën shkelje kur për herën e 4-të, nuk zbaton prapë vendimin e OSHP-së nr:381/19 të datës 21.08.2019 ku thuhet si më poshtë që AK me rastin e rivlerësimit konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë lidhur me këto pretendime se a ka të përfunduara OE i rekomanduar për kontratë, pozicione të njëjta me paramasën e dosjes së tenderit në vlerën e kërkuar të AK- së. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit sqaron se pas pranimit të vendimit të OSHP-së me nr: 3818/19 të datës 21.08.2019, AK ka ri-vlerësuar këtë aktivitet ku pas rivlerësimit rekomandon për kontratë. Grupi i Operatorëve Ekonomik N.N.T. A.B.C. ; KOSOVA ASFALT SH.P.K i treti me radhë nga çmimi i ofruar. OE ankues “Eing com” SH.P.K me çmimin e ofruar renditet si i dyti ku sipas AK në njoftimin me letër standarde herën e parë për tenderuesin e pasuksesshëm thotë se OE është i përgjegjshëm por ka çmimin me të lartë. Ecuria e këtij AP ka vazhduar me paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim nga OE “Eing com SH.P.K. Ku AK pas shqyrtimit të pretendimeve në kërkesën për rishqyrtim kthen lëndën në ri-vlerësim ku rekomandon përsëri për kontratë Grupi i Operatorëve Ekonomik “ALFA - i Konstruktori Ing.1969” që ishte rekomanduar për kontratë edhe herën e parë, dhe pas ankesës në OSHP Paneli Shqyrtues nxjerr vendimin me nr.381/19.

Në vendimin e OSHP-së është kërkuar nga ana e AK-së që të kërkohen sqarime shtesë nga ky grup i OE si në vazhdim.Citoj: Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertës shqyrtuese profesionale të prokurimit thotë: AK duhet konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë lidhur me këto

pretendime se, a ka të përfunduara OE i rekomanduar për kontratë, pozicione të njëjta me paramasën e dosjes së tenderit në vlerën e kërkuar të AK-së. Eksperti shqyrtues sqaron se AK ka dorëzuar dokumente shtesë në OSHP ku të njëjtat i janë dërguar edhe ekspertit shqyrtues. Në këto dokumente janë ofruar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë vetëm për pajisjet ku OE në fjalë ka sjellë DUD Doganor për lugën ngarkuese dhe dëshmitë për cilindrin 18 ton, ndërsa sa i përket kërkesës për sqarime shtesë lidhur me këto pretendime se a ka të përfunduara OE i rekomanduar për kontratë pozicione të njëjta me paramasën e dosjes së tenderit në vlerën e kërkuar të AK-së, eksperti shqyrtues sqaron se në sqarimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk ka sqarime sa i përket pikës në fjalë.

Prandaj nga sqarimet me lart del se pretendimi ankimor është i bazuar. AK nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së me nr: 381/19 të datës: 21.08.2019 në lidhje me sqarimet për përfundimin pozicione të njëjta me paramasën e DT. PËRGGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES“REXHA SH.P.K & LIRIGZONI -S- SH.P.K & LIRIGZONI SH.P.K”.

Pretendimi i parë i OE ankues është se Natyra e referencave lidhur me punët e realizuara, të ofruara nga OE i shpallur fitues lidhën me ujësjellës dhe kanalizime ndërsa natyra e aktivitetit të prokurimit është ndërtim i shesheve dhe bulevardeve. Për këtë pretendim OSHP ka cekur në vendimin me nr. 381/19 të datës 21.08.2019. Lidhur me pretendimin e parë ankimor ku OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në vlerë prej 4,000,000,00 Euro në tri vitet e fundit nga ana e publikimit të njoftimit për kontratë ndërsa si dëshmi është kërkuar të prezantohet një listë e kontratave të realizuara duke saktësuar titullin, shumën, datën dhe për fituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikata për kryerjen e punëve. Ky konzerciumi nuk ka plotësuar kërkesën e njoftimit për kontratë duke ofruar kontrata dhe referenca nga lëmi tjera që nuk janë të ngjashme me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit konstaton se duke u bazuar në kërkesat e AK-së dhe dokumentacionin në lëndë konstaton se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë ka të bashkëngjitur listën e projekteve të përfunduara dhe disa referenca për kontratat e përfunduara, që kanë të bëjnë me ndërtimin e ulët siç janë: Trotuare, ujësjellës, kanalizim, kanale kulluese, rrethoja, parkingje, parqe, fusha të sportit, ura, diga etj. Ky pretendim ankimor është i bazuar dhe AK duhet konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë lidhur me këto pretendime se, a ka të përfunduara OE i rekomanduar për kontratë, pozicione të njëjta me paramasën e dosjes së tenderit në vlerën e kërkuar të AK-së. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë konstaton se sqarimet e ofruara nga OE në fjalë nuk përmbushin kërkesat e Panelit Shqyrtues të paraqitura në vendimin me nr. 381/19 ku në vendimin e OSHP-së thuhet: AK duhet konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë lidhur me këto pretendime se, a ka të përfunduara OE i rekomanduar për kontratë, pozicione të njëjta me paramasën e dosjes së tenderit në

vlerën e kërkuar të AK-së. Prandaj nga kjo qe u tha me lartë del se ky pretendim ankimor qëndron. Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE i shpallur si fitues nuk ka plotësuar kërkesat në njoftim për kontratë që ka të bëjë me listën e pajisjeve dhe makinerisë ku mungon DUDI doganor lidhur me cilindrin minimum 18 ton, po ashtu mungon edhe luga ngarkuese me kapacitet 2m³. Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertës shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë lidhur me këto pika konstaton, sa i përket pretendimit se mungon dudi doganor lidhur me cilindrin minimum 18 ton, në ofertën e dorëzuar ka të bashkangjitur një marrëveshje për marrje me qira të një cilindri nga kompania “Bejta Commerce” ku ka të bashkangjitur faturën tatimore, por i mungon DUD doganor siç ka qenë kërkesë e AK-së në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit, Eksperti shqyrtues sa i përket këtij pretendimi ankimor sqaron se AK ka dërguar sqarimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë në OSHP ku të njëjtat i janë dërguar edhe ekspertit shqyrtues dhe pas shqyrtimit të këtyre dokumenteve eksperti shqyrtues sqaron se OE në fjalë ka plotësuar këtë kërkesë ku sipas vendimit të OSHP me nr.381/19 të datës 21.08.2019. Nga AK është kërkuar që të kërkojë sqarime shtesë në lidhje me këto dokumente. Nga sqarimet me lartë del se AK ka respektuar vendimin e OSHP-së sa i përket kësaj pike ankimor dhe si i tillë ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Pretendimi tjetër i OE ankues është se AK-ja në vendimin e datës 26.09.2019 na ka shpallë të papërgjegjshëm për arsye të pabazuara sepse të gjitha pretendimet se gjoja mungojnë dokumente nuk qëndrojnë përderisa dy herë radhazi kemi qenë të përgjegjshëm dhe për secilin pretendim kemi dokumente të dorëzuara në ofertë, mirëpo pretendimet tuaja janë tendencioze dhe të pa baza. Me këtë vendim AK-ja ka bërë diskriminim ndaj kompanisë tonë. AK-ja në vendimin e saj në kërkesën tonë për ri-shqyrtim vetëm se e ka kamufluar situatën duke i ikur pretendimeve tona të cilat janë të bazuar dhe kanë faktet të bashkangjitura në ofertën tonë. Sa i përket kësaj pike AK ka dhënë përgjigjeje në të gjitha pretendimet tuaja. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lëndë dhe në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar tek arsyet e eliminimit sqaron: Sa i përket pikave tek arsyet e eliminimit në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar eksperti shqyrtues sqaron se kriteri për dhënie ka qenë tenderi me çmimin më të ulët ndërsa oferta e juaj ka çmimin më të lartë se sa OE i rekomanduar për kontratë, prandaj AK nuk ka kërkuar nga ana e juaj informacion shtesë.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Grupit të operatorëve Ekonomik EING COM SH. P. K.; SH – Drini Company SH.P.K të aprovohet si e bazuar dhe ankesa e Grupit të Operatorëve Ekonomik Rexha SH.P.K; LIRIGZONI -S - SH.P.K; LIRIGZONI SH.P.K të aprovohet pjesërisht si e bazuar të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Autoriteti kontraktues, me datë: 28.10.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: "Eing Com" SH.P.K – Podujevë, me datë:28.10.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik:"Rexha – SH.P.K & Lirigzoni - S – SH.P.K" – Prishtinë,nuk është deklaruar rreth raportit të ekspertizës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 30.10.2019, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-ve ankuese, përfaqësuesit AK-së, ndërsa ekspertja shqyrtues na njoftoj përmes telefonit se nuk mundet të vijë në seancë dhe e njëjta na njoftoj se mbetet prapa mendimit të dhënë në Ekspertizë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së së parë ankuese z. Podvorica deklaroi: Sa i përket shqyrtimit të pretendimeve ankimore nga ana jonë, ne pajtohemi me mendimin e kspertes.Ne pas marrjes së materialit të dorëzuar nga ana e konzorciumit të propozuar për dhënie kemi vërejtur se ky konzorcium nuk është i përgjegjshëm ku këtë fakt e ka vërtetuar edhe ekspertja profesionale. Pretendimet tona ankimore kanë qenë të qarta dhe të qëndrueshme andaj sa i përket sigurimit të tenderit operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ka ofruar sigurimin e tenderit nga NLB Banka e i cili sigurim nuk i përmban kushtet e parapara me nenin 57 pika 1 te LPP-së. Ne kemi kërkuar interpretim ligjor nga KRPP dhe në përgjigjen që kemi marr nga ana e tyre thuhet:Sigurimi i tenderit përmendet edhe te neni 39 i RRUOPP.

Në Tabelën e nenit të lartë cekur ku paraqitet "problemi" dhe udhëzimi "si të veprohet?" sa i përket sigurimit të tenderit përcaktohet si në vijim:"Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT " dhe udhëzimi për AK-në është: "Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm".Po ashtu AK gjatë vlerësimit të tenderëve AK me datë:16.09.2019 kërkon zgjatjen e afatit të sigurimit të ofertës për 30 ditë, dhe OE i propozuar për dhënie me rastin e sjelljes së policës së re i ka përfshi pikat të cilat kërkohen të mbuloj polica e sigurimi në këtë fazë të ofertimit e që i bie të ketë ndryshimi material me ofertën e dorëzuar. Autoritetit kontraktues ka qenë dashtë të eliminoj ofertën e operatorit ekonomik te propozuar për dhënie për shkak se Sigurimi i tenderit nuk është ne përputhje me nenin 57 pika 1 té LPP-së.AK pas pranimit të vendimit të OSHP-së nr: 381/19 të datës: 21.08.2019, gjatë rivlerësimit të lëndës në pamundësi ta shpërblej me kontrate konzorciumin e tyre të preferuar "Alfa.i" & "Konstruktori ing"i cili ishte i papërgjegjshëm nga vendimi i OSHP-së, na eliminon edhe neve duke

kaluar te OE-i tjetër sipas renditjes me çmim i 3-ti me radhë, edhe ky OE i preferuar për AK-në, ku pas qasjes në dokumentacion nga ana jonë shihet qartë që OE-ik i propozuar për dhënie nuk është i plotësion kushtet te shpallet i përgjegjshëm dhe AK me rastin e kërkesës për rishqyrtim nga ana jonë e kthen lëndën në rivlerësim dhe përsëri bënë shkelje kur për herën e 4-të, nuk zbaton prapë vendimin e OSHP-së nr: 381/19 të datës: 21.08.2019 ku thuhet si më poshtë që AK me rastin e rivlerësimit konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtese lidhur me këto pretendime se a ka të përfunduara OE i rekomanduar për kontratë, pozicione të njëjta me paramasën e dosjes se tenderit ne vlerën e kërkuar të AK-së.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së së dytë ankuese znj. Cakolli deklaroi: Te nderuar ne qëndrojmë pran pretendimeve tona ankimore dhe pajtohemi pjesërisht me mendimin e Eksperti Shqyrtues, vendimet e Autoritetit Kontraktues janë shume kontradiktore, tendencioze dhe shume diskriminuese, për arsye se në 2 vendime radhas ne kemi qenë të përgjegjshëm dhe herën e fundit me qëllime te caktuar ka shpallur ofertën tone si te eliminuar. Te gjitha pretendimet tona janë te specifikuar qarte ne ankesën tone. Lidhur me mendimin e E.sh ku ka thënë se OE ka ofruar DUD Doganor duke përmbushur kriterin e Autoritetit Kontraktues ne kemi cituar se OE ne fjale ka ofruar DUD Doganor por nuk vërehen qarte te dhënat e pajisjes dhe kemi len te kuptohet se ka mundësi te manipulimit për te cilit do ti drejtohem edhe organeve te tjera për verifikim, lidhur me atë se ne jemi me çmim me te larte dhe nuk ka qenë e nevojshme te kërkohet sqarim me këtë mendim pra me këtë mendim nuk pajtohemi për arsyeje se ne një forme Autoriteti Kontraktues ka bere qëllimisht këtë formë te eliminimit te Ofertës sonë, me qellim për te privuar nga e drejta qe te ushtrojmë ankese ndaj OE-ve te tjera qe sipas mendimit tone janë te pa përgjegjshme si nga ana administrative dhe financiare, d.m.th e çmimit sepse nuk kanë kalkuluar shpenzimet por vetëm materialet. Panel i nderuar duke pare veprimet e Autoritetit Kontraktues qe ne mase te madhe kanë dëmtuar imazhin tuaj si OSHP por edhe duke u munduar te zbehin drejtuesin e vendosur disa here nga ana juaj jo vetëm ne këtë AP por edhe AP te tjera kërkojmë nga ana juaj qe te ndërmerri masa konform LPP-së duke aprovuar ankesën tone dhe te kërkon nga Autoriteti Kontraktues qe gjatë rivlerësimit te bëjë vlerësim te drejtë dhe te kërkoj sqarime konform LPP-së,ne si OE deklarojmë ne qëndrojmë pran pretendimeve tona ankimore. Ndërsa Arsye e eliminimit lidhur ne pozicione 1.9 është shënuar përpilimi i dokumentacionit për secilin Pus sasia komplet është shënuar vetëm njësia dhe nuk është përcaktuar dhe shënuar sasia, kjo shtate neve nuk na ka dhënë mundësinë te vendosim çmimin pasi qe ne nuk kemi te drejtë të ndërhyrë në pjesën kolonën e paraparë për sasinë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së z. Fejza deklaroi: Po i referohem OE te rekomanduar për kontrate, dihet shume mire e kemi përcjell me llupe por është një shkronje, shkronja Z qe nuk vërehet

mirë por mas një kohe është gjetur ai DUD, jemi konsultuar me doganier dhe kanë thënë se janë në rregull, me shkrim nuk kemi dëshmi, por është dëshmi vet DUDI Doganor. Konstatimi i E.sh për sigurim nuk qendror pasi është bazuar në një sigurim të tejkaluar të cilit i ka kaluar afati kur është bërë kërkesa për rishqyrtim, Sigurimi është në rregull të gjithë OE-ve ju kemi kërkuar vazhdimin e sigurimeve dhe i kanë sjellë të gjithë. Sa i përket referencave në i kemi marr të gjitha ato që janë të natyrës së ngjashme, ato kontrata janë që kanë krye Ura me Beton , Fusha sportive, Stadioni I Llapit dhe po ashtu nuk i kemi marr mirëpo i ka kontratat të natyrës së lartë ka Gërmim, Pllaka betoni dhe e tejkalon dyfishin e kërkuar. Unë nuk i kam marr ato referenca me veti mirëpo janë në-prokurim. OE EING kanë qenë të përgjegjshëm ndërsa Tek OE Rexha SH.P.K. pas rivlerësimit ku janë 9 pika, nuk e kanë përmbushur poz 1.9 këta nuk kanë qit çmim fare ka edhe pozicione të tjera që duhet të ju dorëzoj.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së parë ankuese z. Podvorica deklaroj: Kërkojmë nga paneli që ankesën tone ta aprovoj si të bazuar, konzorciumin e propozuar për dhënie ta shpall si të përgjegjshëm dhe lëndën ta kthej në ri-vlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së dytë znj. Cakolli ankuese deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovon ankesën tone si të bazuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Fejza deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të hedhe poshtë ankesat e OE-ve ankuese dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se pretendimet e OE-ve ankues kanë të bëjnë kryesisht kundër OE të rekomanduar për kontrate.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Eing Com" SH.P.K – Podujevë se në dosje të tenderit në "Aneks 4 Siguria E Tenderit" është bashkangjitur edhe forma e sigurisë së tenderit e cila duhet të dorëzohet, me rastin e ofertimit. Në këtë formë saktësisht janë paraparë detyrat dhe obligimet e palëve si dhe kushtet, se kur tërhiqet garancioni. OE i rekomanduar për kontratë me rastin e ofertimit ka dorëzuar një garancion (sigurim) nga NLB Banka por që nuk i mbulon të gjitha pikat siç kërkohet në dosje të tenderit mirëpo paneli shqyrtues sqaron kjo siguri e tenderit ka skaduar gjithashtu se ky operator ekonomik nuk ka

parashtruar ankese ne atë faze kur ka qene sigurimi i tenderit jo sipas dosjes por është pajtuar qe te shpërblehet me kontrate i njëjti OE edhe tani i rekomanduar për kontrate.

Pretendimi tjetër i OE ankues është AK me datë: 16.09.2019 kërkon zgjatjen e afatit të sigurimit të ofertës për 30 ditë, dhe OE i propozuar për dhënie me rastin e sjelljes së policës së re i ka përfshi pikat të cilat kërkohen të mbuloj polica e sigurimit në këtë fazë të ofertimit e që i bie të këtë ndryshimi material me ofertën dorëzuar, Paneli shqyrtues konstaton se është i pa bazuar ky pretendim ankimor pasi qe edhe ata vet e kane dorëzuar sigurimin e ri te tenderit dhe se deponimi i sigurimit te ri nuk paraqet ndryshim material.

Paneli shqyrtues sqaron se ky OE nuk ka parashtruar ankese pranë OSHP-se ne herën e pare qe do te thotë se është pajtuar me vendimin e AK-se por tani pas kthimit te lendes ne rivlerësim nga ana e OSHP-se pasi qe ka parashtruar ankese OE “Rexha” është ankuar ky OE.

Paneli shqyrtues ne vazhdim jep përgjigje për pretendimet te cilat i kane te njëjta te dy operatoret ankues “Eing Com” SH.P.K – Podujevë dhe OE ankues “REXHA SH.P.K & LIRIGZONI -S- SH.P.K & LIRIGZONI SH.P.K”. te cilat kane te bëjnë me Grupin e Operatoreve te rekomanduar për kontratë si me poshtë:

Pretendimi se AK nuk zbaton prapë vendimin e OSHP-së nr: 381/19 të datës 21.08.2019 ku thuhet si më poshtë që AK me rastin e rivlerësimit konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë lidhur me këto pretendime se a ka të përfunduara OE i rekomanduar për kontratë, pozicione të njëjta me paramasën e dosjes se tenderit ne vlerën e kërkuar të AK- së.

Paneli shqyrtues sqaron se pas pranimi të vendimit të OSHP-së me nr: 3818/19 të datës 21.08.2019, AK ka ri-vlerësuar këtë aktivitet ku pas rivlerësimit rekomandon për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik N.N.T. A.B.C.; KOSOVA ASFALT SH.P.K i treti me radhe nga çmimi i ofruar OE ankues “Eing com” SH.P.K me çmimin e ofruar renditet si i dyti ku sipas AK ne njoftimin me letër standarde herën e parë për tenderuesin e pasuksesshëm thotë se OE është i përgjegjshëm por ka çmimin me te lartë. Ecuria e këtij aktiviteti të prokurimit ka vazhduar me paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim nga OE “Eing com SH.P.K. ku AK pas shqyrtimit të pretendimeve në kërkesën për rishqyrtim kthen lenden në rivlerësim ku rekomandon përsëri për kontratë Grupi i Operatorëve Ekonomik “ALFA - i Konstruktori Ing. 1969” që ishte rekomanduar për kontratë edhe herën e parë, dhe pas ankesës ne OSHP Paneli Shqyrtues nxjerr vendimin me nr. 381/19.

Në vendimin e OSHP-së është kërkuar nga ana e AK-së që të kërkojen sqarime shtesë nga ky grup i OE si në vazhdim. Citat: “Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertës shqyrtuese profesionale te prokurimit thotë: AK duhet konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë lidhur me këto pretendime se, a ka te përfunduara OE i rekomanduar për kontratë, pozicione te njëjta me paramasën e dosjes së tenderit ne vlerën e kërkuar të AK-së”. Paneli shqyrtues sqaron se grupi i operatoreve te shpallur fitues ne ofertën e tyre kane dorëzuar listat qe i tejkalojnë kërkesën e AK-se ku si shembull e marrim vetëm Lideri Alfa-i ka te përfunduara pune te ngjashme sipas AK-se qe e tejkalon kërkesën e AK-se. Me poshtë e paraqesim kërkesën e AK-se ne dosje te tenderit:

Kërkesat mbimundësitë teknikedhe/ose profesionale		Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>
	9.1 & 9.2	<p>Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në vlerë minimale prej 4,000,000.00 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në rast të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit</p>	<p>Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve</p>

Nëse e shikojmë sistemin e e-prokurimit AK ka te ngarkuar një dokument me emrin:

Versioni i tanishëm: 07.05.2019 14:45:04 sqarim per Alfa.i.docx

Dhe nëse e hapim këtë dokument kemi sqarimet qe ka kërkuar Alfa-i ne fazën para hapjes se ofertave ku kane parashtruar pyetje dhe AK është përgjigjur si me poshtë (po e shkëpusim vetëm pyetjen e pare):

Pyetja jone eshte keshtu: A llogariten pune te ngjashme edhe Renovimet e objekteve, projektet e ujesjellesit etj?
(renovimet nuk llogariten ndërsa pjojektet e ujesjellesit po)

Qe do te thotë se, për AK-ne edhe projektet e ujesjellesit janë te ngjashme, pra rrjedhimisht vetëm Lideri i grupit Alfa-i ka kryer pozicione te ujesjellesit për periudhën e kërkuar qe e tejkalon kërkesën e AK-se.

Lidhur me pretendimin tjetër, Paneli shqyrtues sqaron se AK ka dorëzuar dokumente shtesë në OSHP ku janë ofruar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë për pajisjet ku OE në fjalë ka sjellë DUD Doganor për lugën ngarkuese dhe dëshmitë për cilindrin 18 ton.

Paneli shqyrtues sqaron se çmimi i OE te pare ankues “Eing Com” është; 2,271,714.10, ndërsa çmimi i OE te dytë ankues “Rexha” është 2,681,712.00€, ndërsa çmimi i OE të rekomanduar për kontratë “Alfa-i dhe Konstruktori” është 2,269,821.95€.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna Podujevë,
- 1x1 “Eing Com” SH.P.K – Podujevë,
- 1x1 “Rexha – SH.P.K & Lirigzoni - S - SH.P.K & Lirigzoni SH.P.K” - Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.